



KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1141 Prot.

Tiranë, më 12.09 2017

VENDIM Nr. 176, datë 05.09.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.11, datë 05.09.2017, pasi shqyrtoi Konceptin dhe metodologjinë e kryerjes së gërmimeve arkeologjike në zonën e përcaktuar si zonë me potencial arkeologjik Chance Find. Vërtop KP 135+800, në kuadër të *projektit të Linjës së Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP)* -subjekti "SPIECAPAG Shqipëria", paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k..

VENDOSI:

1. Të miratojë Konceptin dhe metodologjinë e kryerjes së gërmimeve arkeologjike në zonën e përcaktuar si zonë me potencial arkeologjik Chance Find, Vërtop KP 135+800, në kuadër të *projektit të Linjës së Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP)* -subjekti "SPIECAPAG Shqipëria", paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.
2. Të kryhet gërmimi arkeologjik i shpëtimit, duke lidhur më parë akt-marrëveshje tre palëshe me shoqërinë e licencuar në arkeologji e cila do të kryejë atë, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë shoqëri. Raporti i Gërmimit arkeologjik të shpëtimit të paraqitet në KKA.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al